


# JANARI I FTOHTË



ZEMRAT TONA TË NGROHTA

## RËNDËSIA E NDARJES SË PUSHTETIT

ELSA (12), ERTIJOLA (13), ARBOLEA (12), RUBIN (13), FLODI (12), ERION (13)

**Ndarja e Pushtetit është temë shumë e rëndësishme, por edhe mjaft e gjerë. Qytetarët duhet të jenë të informuar mirë për sa i përket kësaj teme. Për t'i zgjeruar njohuritë tuaja mbi Ndarjen e Pushtetit, lexoni artikullin tonë. Ka fakte, por edhe shembuj të përfshirë. Shpresojmë që do t'iu pëlqej**

Të qenurit në krye të vendit apo në ndonjë pozitë tjetër udhëheqëse, kërkon me të vërtetë punë dhe shumë përkushtim. Kjo sepse kur je në atë pozitë, nuk je përgjegjës vetëm për vetveten, por për një masë më të madhe të qytetarëve. Është sfiduese, por po ashtu është nder dhe privilegj të jesh nën shërbim të të tjerëve.

Mënyra se si funksionon shkolla jonë mund të merret si shembulli më i mirë për të shpjeguar këtë koncept demokratik. Ne jemi disa paralele të klasëve të VII-ta. Secila klasë ka kryesinë e klasës, në krye me kryetarin. Kryesitë e klasave i kanë përgjegjësitë e ndara. Kryetari ka funksion të ndarë prej arkatarit dhe sekretarit. Mirëpo, që të gjithë kanë për qëllim funksionimin

më të mirë të klasës. Nëse ndonjëri nga anëtarët e kryesisë nuk punon siç duhet, atëherë lajmërohet kujdestarja e klasës dhe merren masa për këtë çështje. E njëjta vlen edhe për kryesinë e shkollës. Pra, secili kryetar i klasës e paraqet punën e kryesisë së klasës në këshillin e shkollës.

Për këtë harmonia dhe respekti janë gjithmonë të pranishme në shkollën tonë. Klasët punojnë dhe nuk janë të varura nga njëra-tjetra. Pikërisht kjo është arsyeja që shkolla jonë ka suksese të mëdhaja.

Këtë dëshirojmë ta ndërldhim edhe me mënyrën e funksionimit të shtetit tonë. Më konkretisht, me ndarjen e pushtetit dhe se si e lehtëson kjo ndarje funksionimin e drejtë të shtetit.



Ndarja e pushtetit sipas Kushtetutës



Të ri, të buzëqeshur dhe shumë të lumtur

Ndarjen e pushtetit në vendin tonë e parasheh Kushtetuta e Kosovës, në nenin IV të saj. Për më shumë thuhet: „ Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë“.

Pushteti ndahet në tri degë. Dega e Pushtetit Legjislativ ushtrohet nga Kuvendi. Ky institucion ka për qëllim të bëjë miratimin e ligjeve, për këtë edhe e njohim si Pushteti Legjislativ. Ky është i vetmi institucion që ka të drejtën e miratimit të ligjeve. Degë tjetër e pushtetit është dega Ekzekutive, që ushtrohet nga Qeveria. Qëllimi i saj është të vë në funksion ligjet e miratuara nga

Kuvendi. Dega e fundit e pushtetit është ai Gjyqësor dhe ushtrohet nga gjykata. Kjo e fundit ka për qëllim që të vendos drejtësi. Duke bërë kështu që çdo ligj të zbatohet nga të gjithë qytetarët e vendit tonë.

Siç edhe po e vëreni të dashur lexues, këto institucione punojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Përafërsisht njëjtë siç funksionon edhe shkolla jonë. Ne edhe e morëm shembullin ilustrues se si secila klasë funksionon në mënyrë të pavarur. Me këtë ndarje, çdo gjë është më e lehtë dhe më demokratike. Prandaj, edhe ne preferojmë që gjithmonë të funksionojmë në këtë mënyrë. Le të jetë secili „Zot shtëpie në shtëpinë e vet“. Këto ishin informata tona për ju.

## INFORMOHU DREJT

BRIKENA (12), FLOTA (13), VALON (12), BLERTA (13), ETNIK (12), BLERINA (12), MIRJETA (12)



### Përdorimi i medias në kohën bashkëkohore

Ne si nxënës të shkollës „Fehmi Agani“ duam të tregojmë se mësimdhënësit tanë janë shumë kërkues ndaj nesh. Çdo ditë, secili prej tyre, na kërkon që të bëjmë hulumtime, projekte dhe detyra të ndryshme në lidhje me tema të caktuara. Mësimdhënësit tanë e bëjnë këtë, sepse ata dëshirojnë të na tregojnë neve se ata nuk janë për ne burimi i vetëm i informacioneve. Por, ata janë vetëm udhëheqës të orës mësimore. Ne dëshirojmë ta ndajmë me juve një rast në lidhje me shoqen tonë, Blertën. Për shkak të një problemi shëndetësor, Blerta një ditë nuk mund të vinte në shkollë. Atë ditë, mësimdhënësjja na kërkoi që të hulumtojmë për një shkrimtar. Të nesërmen, kur ajo erdhi në shkollë, ne i treguam se çfarë kishim për detyrë të bënim. Ajo nuk dinte se çfarë të bënte në ato momente. Blerta mori telefonin e saj celular dhe hyri në

„Google“ ku kërkoi informacione mbi shkrimtarin, për të cilin kishim për detyrë të mësonim më shumë. Si përfundim, mësimdhënësjja e pëlqeu shumë punimin e saj dhe gjithashtu e zgjodhi ndër punimet më të mira të asaj dite.

Ne jemi shumë me fat që kemi mundësi të përdorim platforma të ndryshme elektronike, si p.sh.: „Google“, „You Tube“, etj. Ndryshe nga shtetet e tjera jo demokratike, ku qytetarët e kanë të kufizuar të përdorin këto platforma, të cilat i cekëm më lart.

Me këtë artikull, ne donim të tregonim vlerat e medias. Mirëpo, mos të harrojmë të cekim që kemi dy lloje të medias, media të shkruara dhe ato elektronike. Media elektronike momentalisht është më e përdorura nga qytetarët e Kosovës. Por, ne iu sugjerojmë që të mos e leni anash as median e shkruar, sepse edhe ajo ka rëndësinë e vet.




Gazeta është njëra ndër mjetet informuese më të vjetra



Shkathësitë tonë i dëshmuam si gazetarë të suksesshëm

## DETYRAT E DEPUTETËVE TË KUVENDIT

ENRIKA (13), ANITA (12), ISUF (12), DIELLZA (12), ORNELA (12), ALBION (13), ADNIT (13)



**Të dashur lexues, në këtë artikull do të mësoni për zgjedhjet, si dhe për rolin dhe detyrat e deputetëve. Gjithashtu, do të mund të lexoni për pritshmëritë tona nga këta përfaqësues**

Ne sot jemi të pranishëm në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ dhe jemi shumë të gëzuar. Mirëpo, për të ardhur këtu, prindërit tanë kanë votuar. Ne jemi 22 nxënës në klasë, që do të thotë se 22 prindër kanë votuar për ardhjen tonë. Nga ata, 20 prindër votuan pro kësaj ideje. Kurse, vetëm 2 prindër nuk ishin dakord me këtë ide. Sot si pasojë e këtij votimi, 20 nxënës të klasës sonë janë të pranishëm në këtë grup.

Përse ka ndodhur kështu? Kjo ka ndodhur sepse kujdestarja jonë dëshironte që të merrte edhe mendimet e tyre, para se ata të na lejonin të vijmë në këtë Punëtori. Për këtë, ajo iu dha atyre disa formularë për të mundësuar prezencën tonë në Punëtorinë „Demos-ti“. Pasi prindërit mundësuan ardhjen tonë, ne udhëtuan drejt Prishtinës dhe jemi këtu duke realizuar në grupe shumë punime.

Në këtë artikull, ashtu si e lexuat më lart, do të flasim për zgjedhjet dhe deputetët. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve, si zgjedhjet komunale dhe ato parlamentare. Në zgjedhjet komunale, apo ashtu siç quhen ndryshe zgjedhjet lokale, ne votojmë për kryetarin e komunës dhe asamblistët e saj. Ndërsa, në zgjedhjet parlamentare apo qendrore ne votojmë për deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët gjithsej janë 120. Prej



**Ne jemi gazetarët të cilët punuam për këtë artikull** tyre 100 kanë etni shqiptare, 10 i përkasin etnisë serbe, e 10 të tjerë vijnë nga komunitetet e ndryshme jo shumicë: si ashkali, romë, turq, boshnjakë, goranë, egjiptianë, të cilët janë shtetas kosovar. Të jesh deputet është një punë shumë e rëndësishme dhe njëkohësisht shumë e përgjegjshme. Kur të arrijmë moshën 18 vjeçare edhe ne dëshirojmë që të dalim dhe të votojmë për këta deputetë.



**Pjesa tjetër e ekipit, pas punës së palodhshme**


**Të nderuar, më poshtë do të mund të lexoni disa nga kriteret tona për kandidatët për deputetë. Nëse dikush nga ju dëshiron që ndonjë ditë të bëhet deputet, ndoshta këto kritere do t'iu ndihmojnë**

Ne e dimë se në Republikën e Kosovës, personat nën moshën 18 vjeçare nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhjet shtetërore. Por, kjo nuk do të thotë që ne nuk do të jemi në të ardhmen të përfshirë në këtë proces. Për t'iu ndihmuar vetes, ne sot menduam se çfarë kërkojmë ne nga deputetët. Ne nga deputetët kërkojmë që të jenë të përgjegjshëm, të ndershëm, të vendosur, dhe po ashtu shumë punëtorë e zemërgjerë. Ata duhet

të jenë të informuar për punët dhe angazhimet që ata kanë, si dhe për problemet e qytetarëve. Një gjë të vlefshme që duhet ta kenë janë qëndrimet pozitive dhe sjelljet jodiskriminuese. Ndershmëria dhe sovraniteti iu sjell atyre mbështetje nga qytetarët, të cilët kanë nevojë për disa përfaqësues. Këta përfaqësues duhet ta bëjnë më të mirën për vendin e tyre. Vetëm kështu, ata përfundojnë detyrën e tyre si duhet.



**Bashkëbisedimi është gjithmonë zgjidhja më e mirë**



**Ajo që na duhet për të ndryshuar të ardhmen tonë**




**Lumturia ishte e pranishme në çdo hap të ditës së sotme**



**Një e nga një, duke bashkëpunuar, ndriçojmë plot shkëlqim**



**Një deputete e mirë e Kuvendit të Kosovës**



**Mendimet tona në demokraci shprehen**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë